

**DREJTIMI MËSIMOR
“HOTELERI TURIZËM”**

KLASA

11

SHËRBIME PASTRIMI 2

Material mësimor për modulën
e praktikës profesionale të detyruar





NIVELI I

KLASA 11

DREJTIMI MËSIMOR
“HOTELERI TURIZËM”

Moduli

SHËRBIME PASTRIMI 2

**Material mësimor për modulin
e praktikës profesionale të detyruar**

M-13-1355-17
33 orë mësimore

Drejtimi mësimor “Hoteleri Turizëm”

Moduli: Shërbime Pastrimi 2

Material mësimor për modulin e praktikës profesionale të detyruar

M-13-1355-17 | 33 orë mësimore

Përgatiti: **Alma Bit**

Ndihmoi në përgatitje: **Anila Gjinari**

Trajnoi dhe moderoi procesin e hartimit të materialeve mësimore: **Dr. Mirela Andoni**

Redaktore letrare: **Tea Sadiku**

Paraqitja grafike dhe faqosja: **Fatbardha Rama**

Printimi i botimit: **Optima Communication**

Botimi i parë: **Gusht, 2019**

Literatura:

Housekeeping-Manual-pdf

Le metier de femme de chambre.

Laundry proces

House keeping laundry

Les detergents dans une laverie de l'hotel

www.l'hotellerierestauraton.fr

Nettoyage d'une chambre d'hotel

The laundry cycle

Laundry equipment

Copyright: KulturKontakt Austria

Ky material është hartuar në kuadër të projektit ALTOUR: MBËSHKETJA PËR AKSES DHE CILËSI NË ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL PËR SEKTORIN E TURIZMIT, i financuar nga: Austrian Development Cooperation (ADC), me bashkëfinancim nga KulturKontakt Austria (KKA) dhe i zbatuar nga KulturKontakt Austria në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (MFE) dhe partner lokal: Partnerë për fëmijët (PPF).

Në përputhje me synimet e projektit të implementuar nga KulturKontakt Austria, materialet e këtij botimi mund të përdoren vetëm në mësim dhe për qëllime jokomerciale.

Adresa: KulturKontakt Austria, Regional Project Office Tirana, Rruga Naim Frashëri, 37, Tirana

Të dashur mësues, nxënës dhe lexues,

Këtë vit, KulturKontakt Austria feston përvjetorin e saj të 30-të dhe vitin e 25-të të bashkëpunimit me sektorët e arsimit profesional dhe arsimit të përgjithshëm në Shqipëri!

Turizmi ka qenë një nga fushat e përbashkëta të bashkëpunimit që në fillim. Në Shqipëri dhe Austri, trashëgimia e pasur kulturore dhe peizazhet e bukura e të larmishme janë themeli për zhvillimin e suksesshëm të sektorëve tanë të turizmit. Megjithatë, një faktor po aq i rëndësishëm suksesi janë edhe njerëzit e mirëtrajnuar, të orientuar drejt shërbimit dhe sipërmarrjes, që punojnë në sektorin e turizmit, të cilët i bëjnë turistët të ndihen të mirëpritur dhe sigurojnë produkte dhe shërbime cilësore e të qëndrueshme.

Për sektorin e AF-së në fushën e turizmit, mikpritjes dhe furnizimit me ushqim, kjo nënkupton përditësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore, për të reflektuar njohuritë dhe aftësitë që nevojiten me të vërtetë në tregun e punës. Përmes zhvillimit profesional, mësimdhënësit duhet të mbështeten për organizimin e procesit mësimor të orientuar drejt praktikës, i cili i ndihmon nxënësit për përfitim të kompetencave të nevojshme profesionale. Duhet krijuar dhe duhet zhvilluar formate të reja për bashkëpunimin me sektorin privat. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, procesi mësimor duhet të mbështetet nga materialet e duhura mësimore.

Projekti Al-Tour: “Mbështetja e cilësisë dhe qasja tek arsimi dhe formimi në fushën e turizmit në Shqipëri” po mbështet reformën në sektorin e arsimit dhe formimit në fushën e turizmit në këtë vend. Edhe materiali mësimor në dispozicion është përgatitur në kuadër të këtij projekti.

Materiali ju ofron udhëzime dhe ide se si të fitoni njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për të nisur një karrierë të suksesshme në sektorin e turizmit, mikpritjes dhe furnizimit me ushqim në profesionin që keni zgjedhur.

Dëshiroj t’u uroj suksese të gjithë përdoruesve të këtij materiali në realizimin e detyrës së tyre shumë të rëndësishme: krijimi i mundësive për sektorin e turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri për të zhvilluar potencialin e tij të plotë dhe për shumë të rinj për gjetjen e shtigjeve sa më interesante në karrierën e tyre.

Dua ta shfrytëzoj këtë mundësi për të falënderuar partnerët tanë të projektit, Ministrinë Shqiptare të Financave dhe Ekonomisë, Agjencinë e Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, bashkitë dhe konviktet në Korçë, Sarandë dhe Tiranë, shkollat tona partnere dhe organizatën partnere lokale “Partnerë për Fëmijët” (PPF) për bashkëpunimin e tyre të shkëlqyer. Falënderimet e mia të veçanta shkojnë për Agjencinë Austriake për Zhvillim, nga e cila financohet ky projekt.

Jakob Calice

Drejtor i KulturKontakt Austria

PËRMBAJTJA

RM1 Nxënësi/ja pranon, parapërgatit, magazinon dhe dorëzon të linjtat	6
1.1 Veshja e uniformës në vendin e punës	7
1.2 Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për pranimin e të linjtave sipas rregullit	8
1.3 Marrja në dorëzim dhe seleksionimi i të linjtave sipas ngjyrave, përbërjes së materialit dhe shkallës së ndotjes	8
1.4 Seleksionimi i të linjtave sipas sektorëve të hotelit dhe sipas rregullit	9
1.5 Marrja në dorëzim dhe etiketimi rrobave të klientit sipas rregullit	10
1.6 Kryerja e trajtimit të njollave sipas rregullit	11
1.7 Transportimi dhe klasifikimi i të linjtave dhe rrobave të tjera për larje	12
1.8 Përzgjedhja e programit larës sipas etiketës	13
1.9 Zbatimi i procesit të tharjes së rrobave	13
1.10 Seleksionimi i të linjtave dhe rrobave të tjera sipas procesit të hekurosjes dhe hekurosja e tyre sipas treguesit të etiketës.	13
1.11 Palosja, paketimi dhe sistemimi i të linjtave të pastra dhe rrobave të klientit sipas rregullit	14
1.12 Magazinimi dhe dorëzimi i të linjtave së pastër dhe rrobave të tjera sipas sektorëve me dokumentacion përkatës	14
1.13 Zbatimi i rregullave të higjienës personale, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes fizike në vendin e punës	15
1.13.1 Zbatimi i rregullave të higjienës personale dhe të vendit të punës.	15
1.13.2 Zbatimi i rregullave të mbrojtjes/sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit.	16

RM2 Nxënësi/ja kryen procesin e larjes së të linjtave në lavanderi	18
2.1 Veshja e uniformës në vendin e punës	19
2.2 Punët parapërgatitore për larjen e të linjtave dhe rrobave të tjera me makinën larëse	19
2.3 Përzgjedhja e detergjenteve larës, llogaritja e dozimit dhe vendosja e detergjenteve në vendet e përcaktuara sipas rregullit	20
2.4 Përcaktimi i programeve të larjes sipas llojit dhe etiketës	21
2.5 Punët pas larjes	22
2.6 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në lavanderi	22
 RM3 Nxënësi/ja kryen procesin e hekurosjes së të linjtave në lavanderi	 23
3.1 Veshja e uniformës në vendin e punës	24
3.2 Punët parapërgatitore për hekurosjen e të linjtave në lavanderi	24
3.3 Kryerja e procesit të hekurosjes	24
3.4 Punët pas përfundimit të hekurosjes	25
3.5 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në lavanderi	25

REZULTATI MËSIMOR NR.1

NXËNËSI/JA PRANON, PARAPËRGATIT, MAGAZINON DHE DORËZON TË LINJTAT



1.1 Veshja e uniformës në vendin e punës

Shumë hotele i pajisin punonjësit e tyre me uniformën dhe etiketën e emërimit të përcaktuar. Etiketa e emrit mund të përmbajë emrin dhe pozicionin e punës, p.sh.: “ Drita/Genc, Lavanderi”. Kjo uniformë duhet veshur gjithmonë pasi shërben për shumë qëllime dhe përfitime.

Disa prej tyre janë:

- Identifikimi më i lehtë nga kolegët dhe klientët.
- Mbrojtja e rrobat nga ndotja ose dëmtimi.
- Mbrojtja nga kimikatet dhe materiale me të cilat punoni.
- Sigurimi i një pamje elegante dhe profesionale duke përmirësuar kështu imazhin e departamentit të lavanderisë.

Kujtoni gjithmonë:

- Vishni uniformën e punës në vendin e përcaktuar të departamentit të lavanderisë, i cili mund të jetë një dollap ose raft në emrin tuaj.
- Ndërroni uniformën sa herë është përcaktuar nga përgjegjësi i lavanderisë ose sa herë të nevojitet.
- Mbani uniformën në kushte të mira duke raportuar për çdo riparim të nevojshëm ose kujdesuni vet për këtë sipas rregullores së departamentit.
- Sigurohuni që uniforma juaj e ka të plotë setin e kopsave gjithë kohën.
- Respektoni çdo kod që institucioni juaj ka vendosur për sa i përket veshjes së uniformës, si p.sh.: nuk lejohet të pihet duhan me uniformën e punës ose është e ndaluar të hyni me uniformën e punës në departamente që shitet alkool, të tilla si baret.
- Vendosni baxhën sipas rregullores së hotelit.



1.2 Përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës për pranimin e të linjtave sipas rregullit

Grumbullimi i të linjtave dhe rrobave të tjera bëhet në zonën e ashtuquajtur “e ndotur”. Rrobat vijnë të grumbulluara në qese me ngjyra të ndryshme. Në zonën përkatëse ka kosha për ruajtjen e rrobave derisa të kalojnë në procesin e larjes. Koshat paraprakisht duhet të jenë të kontrolluar për pastërtinë dhe funksionimin, p.sh. punonjësi/ja në përgjegjësi ka për detyrë të kontrollojë sistemin e rrotave. Koshat duhet të jenë gati në pozicionin e përshtatshëm për të lehtësuar punën e transportuesit. (shembull ilustrues Figura 1.) Përdorimi i karrocave ose koshave në vend të qeseve plastike lë një përshtypje më të mirë tek klientët. Punonjësi/ja hyn dhe del nga e njëjta portë hyrëse dhe nuk ka akses me zonën e pastër për të mos lejuar kontaminim.



Figura 1.

1.3 Marrja në dorëzim dhe seleksionimi i të linjtave sipas ngjyrave, përbërjes së materialit dhe shkallës së ndotjes

Marrja në dorëzim e të linjtave dhe rrobave të tjera është një proces me shumë përgjegjësi sepse ka riskun e kontaminimit dhe shëndetin e punonjësit. Për këtë arsye, punonjësi/ja duhet të jetë i mbrojtur me doreza, jo një përdorimshe, me uniformë të rregullt dhe maskë në gojë për të mos lejuar kontaminimin nëpërmjet gojës dhe kalimin e mikrobeve në organet e brendshme.

Marrja në dorëzim e të palarave bëhet me një dokument dorëzimi me listën e artikujve që mund të jenë çarçafë, peshqirë, uniforma punonjësish ose rroba të ndryshme të klientit. Këtu hyn në lojë procesi tjetër i seleksionimit. Ky është një proces që kërkon njohuri dhe eksperiencë.

Të linjtat dhe rrobat e tjera të klientëve seleksionohen sipas ngjyrave. Sigurisht të bardhat nuk përzihen me asnjë ngjyrë tjetër. Kjo ndarje bëhet nëpër kosha të veçante më ngjyra të përcaktuara nga rregullorja e departamentit të lavanderisë ose hoteli.

Përbërja e materialit të linjtave dhe rrobave është një element tjetër i rëndësishëm dhe i pa evitueshëm, sepse ky proces ndihmon në larjen në temperaturën e duhur dhe siguron kështu ruajtjen dhe jetë-gjatësinë e tyre.

Seleksionimi i të linjtave dhe rrobave në lananderitë e hoteleve kushtëzohen edhe nga shkalla e ndotjes. Rrobat me ndotje më të vogël vendosen në karroca të veçanta sepse kërkojnë më pak kohë larjeje dhe më pak detergjent. Me këtë seleksionim harxhohet më pak energji, detergjent dhe ruhet materiali. Të linjtat, të cilat janë shumë të ndotura vendosen veç në një vend të dukshëm në mënyrë që më të mbërritur në lavanderi të trajtohen të parat.

1.4 Seleksionimi i të linjtave sipas sektorëve të hotelit dhe sipas rregullit

Në hotel ka disa sektorë të cilët kërkojnë çdo ditë furnizim me të linjta të pastër. Restoranti ka kërkesë për mbulesa tavoline dhe peceta, stafi i pastrimit të hotelit për çarçafët e peshqirë. Siç e vëmë re, janë artikuj të ndryshëm që rreptësisht nuk mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin. Për këtë arsye, detyra e punonjësit të lavanderisë është që ti seleksionojë sipas sektorëve: të linjtat e dhomave të hotelit, peshqirët dhe uniformat e kuzhinës, mbulesat dhe pecetat e restorantit, pecetat dhe uniformat e barit etj. Por njëkohësisht duhet të ndajë edhe artikuj brenda një sektori. P.sh. artikujt të krevatit dhe të banjës dhe t'i vendos në kontejner të ndryshëm.

Të linjtat ndahen sipas kategorive:

Çarçafët ndahen nga këllëfët dhe kontrollohen nëse ka sende personale të klientëve, të cilat gabimisht janë marrë së bashku me caracët. Këto të fundit lahen dhe kthehen tek klienti.

Këllëfët duhet të ndahen nga çarçafët pasi është me lehtë të ndahen pas larjes dhe tharjes.

Mbulesat e shtretërve lahen në temperatura të ndryshme në varësi të materialit.

Peshqirët lahen së bashku, por të ndarë nga peshqirët me ngjyra.

Peshqirët me ngjyra, sektorët si SPA apo pishina përdorin peshqirë me ngjyra. Në përgjithësi ato janë të ndotura me vajra masazhi apo njolla të tjera, për pasojë ato duhet të trajtohen dhe të lahen veçmas.

Peshqirët e trupit lahen veçmas.

Mbulesat e tavolinave ndahen për të larguar mbetjet ushqimore, shërbime të ngrënies dhe në disa raste edhe porcelane nëse janë mbledhur gabimisht me mbulesat. Prezenca e këtyre të fundit gjatë procesit të larjes krijon dëmtime të pajisjeve larëse si dhe të mbulesave.

Peshqirët e pastrimit rekomandohet të kenë ngjyra të ndryshme sipas sektorëve për:

1. për të identifikuar;
2. për të reduktuar kontaminimin e kryqëzuar p.sh. një peshqir i përdorur në kuzhinë mund të lerë njolla në pastrimin e gotave.


Ndarja e tyre bëhet sipas sektorëve.

Peceta pastrimi dhe shtupat e dyshemesë duhet të lahen çdo ditë dhe të ndahen sipas sektorëve.



Këto foto ilustronë materialin që është paraqitur më lart dhe shërbejnë për të kuptuar më mirë disa procese pune.

Foto: cikli nëpër të cilin kalojnë proceset e lavanderisë.



1.5 Marrja në dorëzim dhe etiketimi rrobave të klientit sipas rregullit

Rrobat e klientëve janë të një përgjegjësie të madhe sepse janë delikate dhe trajtimi i tyre ndikon drejtpërdrejt me kënaqësinë e klientit dhe besnikërinë e tij për tu rikthyer. Për këtë arsye ato kalojnë në disa procese të domosdoshme dhe të paracaktuara. Pasi merren në dorëzim, rrobat e klientit etiketohen me një mekanizëm të vecantë të komanduar dhe ku mund të shkruhet data e marrjes, data e dorëzimit, lloji i materialit, cilësia e materialit, dëmtimet e mundshme, trajtimet e vecanta dhe të dhëna të tjera të nevojshme për proceset e pastrimit etj.



Leximi i etiketave, testimi për kopsa, testi i shoqërimit për ndjeshmërinë e ngjyrës.

Tre elementë të tjerë të rëndësishëm për përgatitjen e rrobave për larje janë:

Leximi i etiketave - në etiketa gjejmë përbërjen e materialit, përqindjen e poliestrës, përdorimi i detergjenteve, zbardhuesve ose jo, temperatura e larjes dhe gradimi i hekurosjes.

Testimi i kopsave - ky veprim kryhet për të hequr kopsat e lëvizshme dhe për të kontrolluar ndërkohë në xhepa për mjete të rrezikshëm për mirëmbajtjen e makinerive dhe sigurinë e punonjësit si, sende me majë, gërshërë, sende prerës ose sende të tjera të klientëve që mund të dëmtohen dhe që janë harruar atje pa dashje, si p.sh, karta identiteti, çelësin e dhomës, monedha, fatura të ndryshme etj.

Testimi i ndjeshmërisë së ngjyrës - mos harroni të bëni testin e ndjeshmërisë dhe dekolorimit të ngjyrave nëse nuk jeni të sigurt dhe nëse e lani për herë të parë një veshje të klientit. Bëni këtë test të thjeshtë para se të ndodheni para ndonjë të papriture. Lageni veshjen me ngjyrë në një vend të padukshëm, pastaj fërkojeni me një copë rrobë të bardhë të lagur dhe atë për të parë nëse çngjyroset. Nëse ndodh kjo, atëherë vendoseni këtë veshje të etiketuar për tu larë me rroba me të njëjtën ngjyrë ose të lahet veçmas.

1.6 Kryerja e trajtimit të njollave sipas rregullit

Njollat më të shpeshta që gjenden në të linjta e dhomës dhe peshqirë janë:

- djersa;
- vajra të flokëve;
- kremra trupi;
- kozmetika;
- lëngjet e trupit.

Shënim i veçantë për lëngjet e trupit

Nëse në të linjta e dhomave apo nëpër peshqirë gjenden sasi të mëdha gjaku, feçe, urinë apo të vjella, gjithmonë duhet të trajtohen si të linjta me potencial infektues. Këto të linjta duhet të mbahen të ndara nga ato pak të ndotura. Punonjësit e pastrimit duhet të ketë veshur doreza kur trajtojnë këto bankeri. Para se të dërgohen në lavanderi, të linjtat trajtohen për të larguar mbetjet e ngurta dhe futen në qese të forta plastike me lidhëse të cilat janë zakonisht janë me ngjyrë të kuqe. Këto qese dërgohen direkt në makinat larëse dhe janë të shënuara për tu trajtuar në mënyrë të veçantë.

Njollat më të shpeshta në mbulesa e peceta janë nga:

- vera e kuqe;
- buzëkuqi;
- ngjyrim nga produktet ushqimore;
- vaji;
- gjalpi etj.

Para se të lahen, rrobat e ndotura me njolla të vështira, vendosen mënjanë duke marrë parasysh ndotjen, ngjyrën dhe llojin e fabrikimit.

Disa mënyra për heqjen e njollave:

- Zbutja për 24 orë në ujë të ftohtë i të linjtave ose rrobave që janë prodhuar nga material i fortë dhe janë shumë të pista.
- Larja me ujë dhe sapun dhe disa fërkime derisa të zhduket njolla nga rrobat. Yndyrat dhe vajrat shpërbëhen më mirë dhe më shpejt në ujë të ngrohtë.
- Zierja e të pambuktave dhe linove në ujë me sapun për 20-30 minuta. Zierja më gjatë se kaq ka tendencë të zverdhtë të bardhat. Gjithashtu duhet të mënjanohet larje me më shumë rroba se sa ujë.
- Shpëlarja e sapunit me ujë të vakët. Artikujt prej lëkure shpërlahen veçmas.
- Zbardhuesi i rrobave (të bardha) gjendet në trajtën e lëngët, pluhur ose kub. Ky detergjent ka cilësinë e mbulimit të çngjyrosjes së padëshiruar dhe e bën veshjen më të bardhë se realisht.
- Largimi i njollave të gjakut me amoniak. Ekspertët tregojnë se amoniaku ndihmon në largimin e njollave të gjakut. Paraprakisht mos harroni të vishni dorëza gome, dhe sigurohuni se dhoma është e ventiluar para se ta përdorni substancën. Për ta zbardhur rrobën e caktuar, përzieni 4 pika amoniaku, një lugë gjelle peroksid hidrogjeni, 2 litra ujë. Lini rrobat ose gjërat tuaja për disa orë në atë përzierje, ndërsa në fund pastroni me detergjent.
- Largimi i njollave të buzëkuqit me tul të bukës. Për t'i larguar njollat e buzëkuqit, merrni tulin e bukës së bardhë dhe bëjeni në formë topi. Me atë fërkojeni njollën dhe pastaj pastroni rrobat si zakonisht. Rekomandohet ta bëni këtë posa të shfaqet njolla.
- Largimi i njollave të lapsit me pastrues xhami. Për t'i larguar njollat e lapsit kimik, përdorni pastrues xhami. Vetëm spërkateni njollën me pastrues të xhamit dhe lëreni ashtu për 5 minuta. Pastaj, pastroni rrobat si zakonisht.



Disa mënyra për heqjen e disa njollave në material të ndryshme në të linjtat e hotelit dhe në veshjet e klientëve

1.7 Transportimi dhe klasifikimi i të linjtave dhe rrobave të tjera për larje

Pasi bëhet marrja në dorëzim dhe seleksionimi i të linjtave dhe rrobave të tjera, bëhet transporti i tyre i seleksionuar sipas sektorëve të hotelit, përbërjes së materialit, ngjyrave dhe shkallës së ndotjes. Transporti mund të bëhet në mënyrë manual me karroca të veçanta të etiketuara sipas procesit ose automatike me shkalla lëvizëse dhe makineri me ndarje sipas procesit. Këtu mund të kemi të përcaktuar edhe temperaturën, sasinë e detergjentit dhe kohën e larjes.

1.8 Përzgjedhja e programit larës sipas etiketës

Në zonën e përzgjedhjes, punonjësi kujdeset të etiketojë të linjtat dhe rrobat e tjera. Etiketimi bëhet në thasët ose karrocet e transportit, por në rastet e rrobave dhe uniformave etiketën e gjejmë edhe në secilin artikull. Kur arrijnë rrobat tek makina larëse, personi përgjegjës për mbushjen e makinës larëse, përzgjedh programin e larjes për secilin paketim të seleksionuar. P.sh. peshqirat e hotelit kanë program tjetër nga uniformat e punonjësve të kuzhinës. Programi i larjes sipas etiketës bëhet edhe duke lexuar udhëzuesin e punës së makinës larëse. Makinat larëse janë të ndryshme dhe me fuqi larëse të veçantë për të pambuktat, për peshqirat, për poliestër, pëlthurë, stof etj. Për këtë arsye, kërkohen punonjës të kualifikuar me eksperiencë. Personi përgjegjës në këtë departament ka për detyrë të bëjë të qartë detyrat për çdo proces pune, por edhe të kualifikojë punonjësit e rinj nëpërmjet trajnimeve të brendshme.

1.9 Zbatimi i procesit të tharjes së rrobave

Sipas fuqisë së makinës larëse do të kemi edhe rezultatin kohor të larjes. Rrobat me shkallë ndotje më të vogël lahen në program më të shkurtër kohor. I nxjerrim nga lavatriçja dhe i kalojmë në makinerinë rrëshqitëse për t'i kaluar në procesin tharës. Kini kujdes gjatë transferimit të rrobave nga lavatriçja larëse në tharëse sepse pesha e tyre rritet pas larjes. Përdorni tharësin automatik siguron tharje me goditje ajri të nxehtë. Tharja e të linjtave dhe rrobave nëpërmjet makinerisë tharëse bëhet për disa arsye: për kursim kohe, për efekt estetik, për ruajtjen e lagështirës së nevojshme për hekurosje perfekte.

1.10 Seleksionimi i të linjtave dhe rrobave të tjera sipas procesit të hekurosjes dhe hekurosja e tyre sipas treguesit të etiketës.

Rrobat e thata vendosen në kosha të pastër dhe transportohen në zonën neutrale të seleksionimit sipas etiketës për të kaluar në zonën e hekurosjes. Qëllimi i seleksionimit dhe përgatitjes për hekurosje është mundësia e hekurosjes me hekur dore, me presë, me rul ose me anë të hekurosjes më avull. P.sh. çarçafët hekurosen me rul, këmbishët e klientëve më hekur dore ose presë, uniformat e punonjësve me avull etj. Hekurosja sipas etiketës ka për qëllim ruajtjen e artikujve nga hekurosja më temperaturë të lartë që mund të shkaktojë prishjen, djegien dhe njëkohësisht heqjen nga inventari. Kjo gjë do t'i kushtonte biznesit, prandaj kërkohet vigjilencë dhe përpikmëri në kryerjen e veprimeve.



Foto A:
Hekurosje me presë



Foto B:
Hekurosje me hekur dore



Foto C:
Hekurosje me avull



Foto D:
Hekurosje me rul

1.11 Palosja, paketimi dhe sistemimi i të linjtave të pastra dhe rrobave të klientit sipas rregullit

Palosja dhe paketimi në hotele me kapacitet të madh realizohet me makineri automatike lëvizëse, të cilat ndihmojnë stafin të shpëtojë nga lëvizjet e lodhshme, kursejnë kohë dhe ambalazh për paketim. Disa lloj të linjtash, uniformat e punonjësve dhe rrobat personale të mysafirëve ende kanë nevojë për palosje manuale. Preferohen makinat palosëse për të arritur cilësi paketimi dhe lehtësi në sistemimin dhe stivosjen e tyre në raftet përkatëse të magazinës.

1



2



3



4



Procesi i palosjes duke përdorur makinat palosëse

1.12 Magazinimi dhe dorëzimi i të linjtave së pastër dhe rrobave të tjera sipas sektorëve me dokumentacion përkatës

Të linjtat dhe rrobat e tjera të pastruara dhe hekurosura transportohen në vendin e magazinimit, i cili ndodhet në zonën e pastër të grumbullimit. Për këtë arsye, të tjerë punonjës punojnë në zonën e punës dhe të tjerë në zonën e pastër. Rrobat janë të vendosur në kosha të mëdhenj sipas sektorëve përkatës dhe transportohen në magazinë në vendet që janë paracaktuar për tu vendosur në raftet përkatëse. Edhe vendosja në raste ose stivosja bëhet sipas sektorëve të hotelit. Një vend stivohen të linjtat e dhomave të hotelit, çarçafët, këllëfët, peshqirët, në një vend vendosen të linjtat e restorantit, barit, uniformat e kështu me radhë. Rrobat e klientëve seleksionohen dhe stivohen sipas dhomave të hotelit. Sistemimi, stivosja dhe magazinimi i rregullt e bën më të lehtë punën e dorëzimit të tyre sipas sektorëve me dokumentacionin përkatës.



Sistemimi



Stivosja dhe magazinimi



Transportimi

1.13 Zbatimi i rregullave të higjienës personale, të sigurisë në punë dhe të ruajtjes fizike në vendin e punës

Hotelet kanë standarde për prezantimin personal të punonjësve, të cilat mund të jenë zyrtare ose jozyrtare. Gjithashtu ato vendosin rregulla mbi paraqitjen dhe higjienën personale.

1.13.1 Zbatimi i rregullave të higjienës personale dhe të vendit të punës.

Higjiena personale:

- flokë të pastër të mirëmbajtur dhe të mbledhur ose të mbuluar me një shall ose kapele;
- thonjtë të pastër dhe të prerë. Thonjtë nuk duhet të jenë shumë të gjatë sepse mund të dëmtojnë të linjtat ose rrobat e tjera;
- bizhuteritë (ora, varësja, vëthët, byrzykët) janë të rrezikshme në punët e lavanderisë përfshirë këtu edhe unaza e martesës.



Higjiena e vendit të punës

Rregullat e higjienës së vendit të punës në një lavanteri bazohen realisht në një menaxhim të mirë të hapësirës : të linjtat e pastra dhe të linjtat e pista nuk duhet të kryqëzohen për të evituar kontaminimin. Për ta realizuar këtë, lavanteria profesionale një hoteli duhet të përbëhet nga dy zona të vecanta. Një rregull tjetër themelor është mirëmbajtja e rregullt e pajisjeve dhe ambjenteve të punës. Ndotja e rrobave mund të bëhet edhe nga pajisjet (p.sh, karroca e transportit të rrobave, kanali i ventilimit). Për të ruajtur një mjedis të shëndetshëm është i rëndësishëm hartimi i një plani për të pastruar ambientet dhe pajisjet. Dezinfektimi i ambientit pas largimit të të pistave është një rregull tjetër që rrit sigurinë e higjienës së vendit të punës.



Plani i pastrimit dhe dezinfektimit të zonës së grumbullimit të linjtave dhe rrobave të ndotura

Pastrimi/ Dezinfektimi									
Data	1	2	3	4	5	6	7	8	Emri/Mbiemri
1. muret;									
2. dyshemetë;									
3. makineritë larëse;									
4. makineritë tharëse;									
5. makineritë e hekurosjes;									
6. karrocat e transportit;									
7. raftet e të linjtave;									
8. koshat.									

1.13.2 Zbatimi i rregullave të mbrojtjes/sigurisë në punë dhe ruajtjes së mjedisit

Për zbatimin e rregullave të mbrojtjes në punë dhe ruajtjes së mjedisit duhet: së pari të dimë dhe të bëhemi të ndërgjegjshëm mbi rreziqet profesionale në departamentin e lavanderisë dhe së dyti të kemi siguruar masat mbrojtëse dhe parandaluese ndaj rreziqeve për mbrojtjen e punonjësve, mjeteve të punës dhe ambientit të lavanderisë.

Rreziqet profesionale në departamentin e lavanderisë janë:

Rreziqet kimike - produktet kimike (detergjentet, dezinfektuesit, heqësit e njollave të vështira etj.) që përdoren në lavanderi janë rrezik për punonjësën, pajisjet e punës, të linjtat dhe vendin e punës. Për arsye të aciditetit të tyre të fortë dhe me doza të koncentruara, këto produkte janë gërryese, irrituese, alergjike dhe mund të dëmtojnë punonjësën nëpërmjet kontaktit ose futjes në lëkurë por gjithashtu edhe nëpërmjet frymëmarrjes.



Rreziqet termike - lavanderia ekspozohet në një temperaturë të lartë që përhapet nga makinat larëse, tharëse dhe të hekurosjes. Kontakti direkt i lëkurës me sipërfaqet e nxehta ose nga shpërthimet e avullit mund të shkaktojë djegie të rënda. Afërsia pranë një burimi nxehtësie mund të shkaktojë tension të lartë, rrahje të shpeshtë të zemrës, dehidratim dhe shqetësime në qarkullimin e gjakut, pa nënvleftësuar edhe pasojat psikologjike.

Rreziqet biologjike - punonjësët e lavanderisë janë të ekspozuar tek agjentët mikrobiologjik (bakteret, viruset, parazitët, mykut) të cilët janë burime të infeksioneve dhe sëmundjeve nëpërmjet kontaktit të lëkurës, frymëmarrjes, prerjet ose shpimet e shkaktuara nga sende të padëshiruara (si gjilpërë, gërshërë) si dhe kalimit të mikrobeve nga

duart në gojë nëpërmjet kontaminimit të kryqëzuar.

Rreziqet fizike - lëvizjet e shumta, qëndrimet dhe veprimet e përsëritura mund të shkaktojnë dhimbje kronike të mesit, shpinës, gjymtyrëve të sipërm, kyçeve të dorës, bërrylave. Rrezik përbën edhe mbartja e peshave të rënda



gjatë transportimit të linjtave si dhe lëvizjet e përsëritura të pëllëmbës së dorës gjatë veprimeve të hekurosjes me dorë, palosjes, etiketimit etj.

Lodhja akustike e shkaktuar nga puna në zhurmën permanente të makinerive gjithmonë në punë.

Rrëshqitja në dyshtet e lagur nga makinat larëse ose rrjedhje uji në lavanderi.

Një ndriçim i dobët bëhet shkak i lodhjes vizuale. Dëmtimet si prerje dhe goditje që mund të shkaktohen gjatë zhvendosjes së pjesëve të lëvizshme të makinerive, nga ndalesat jonormale të makinerive për shkak të ndërprerjes së energjisë ose gjatë pastrimit të tyre. Rreziku elektrik që shkaktohet nga përdorimi i shumë makinave njëherazi në një atmosferë me lagështirë.

Rreziqet nga zjarri - makineritë difektoze që shkaktojnë një qark të shkurtër ose mbingrohje, një instalim elektrik të gabuar, vetë-ndezja e rrobave nga fermentimi, detergjentet oksidues dhe stoqet e djegshme të tretësve favorizojnë rënien e zjarrit në lananderitë e hoteleve.

Masat mbrojtëse ndaj rreziqeve për mbrojtjen e punonjësit, vendit të punës dhe mjedisit

Parandalimi më efektiv është:

Parandalimi parësor që përfshin futjen e teknologjive që lejojnë veprime mbi produktet (heqja nga përdorimi ose përdorimi i produkteve zëvendësuese të cilat kanë më pak ndikim potencial mbi njerëzit) dhe teknologji që lejojnë veprime mbi proceset (përdorimi i pajisjeve ose makinerive që eliminojnë ose kufizojnë sa më shumë që të jetë e mundur ndikimet nga shkarkimet atmosferike dhe ato të nivelit të zhurmës).

Parandalimi kolektiv përfshin përdorimin e sistemeve prodhuese të izoluar dhe të automatizuara si dhe të pajisjeve mekanike (si nxjerrja e avujve) për të zvogëluar ekspozimin e punëtorëve, veçanërisht kur për arsye teknike, kimikate të rrezikshme nuk mund të zëvendësohen me kimikate të tjera të parrezikshme.

Së fundi, veshja e pajisjeve mbrojtëse personale (mbulesa, doreza, këpucë mbrojtëse, etj.) është e detyrueshme për të zvogëluar rrezikun e ekspozimit të pa eliminuar plotësisht nga masat mbrojtëse kolektive. Gjithashtu në ambientet e punës nuk duhet të mungojnë pajisjet dhe materialet mbrojtëse të ndihmës së parë.

REZULTATI MËSIMOR NR.2

NXËNËSI/JA KRYEN PROCESIN E LARJES SË TË LINJTAVE NË LAVANDERI



2.1 Veshja e uniformës në vendin e punës

Kjo temë është trajtuar në RM1.


2.2 Punët parapërgatitore për larjen e të linjtave dhe rrobave të tjera me makinën larëse

Misioni i punonjësit në lavanderi është prodhojë të linjta mikrobiologjikisht të pastra, të shpërndajë llojet e tekstileve dhe sasinë e nevojshme sipas aktivitetit specifik çdo makinerie larëse ose tharëse dhe të sigurojë higjienën e të linjtave dhe rrobave në të gjitha drejtimet.

Larja është një etapë nga më të rëndësishmet në gjithë procesin e mirëmbajtjes së të bardhave. Efikasiteti i larjes ndikon si në shëndetin publik edhe në performancat ekonomike të institucionit (restorant, hotel, spital, etj.)

1. Verifikimi i funksionimit të pajisjeve larëse.

Punonjësi i lavanderisë është kualifikisht i formuar edhe për të verifikuar pajisjet larëse. Në rast të kundërt, sidomos në lavanderitë e mëdha, është një person përgjegjës për të kryer këtë proces. Kontrollon pastërtinë, rrymën elektrike dhe sigurimin teknik.



2. Seleksionimi i të linjtave për larje.

Kjo është etapa më delikate sepse punonjësi është në kontakt direkt me elementët patogjen të rrobave të palara. Hapat e seleksionimit janë:

- ndarja e rrobave sipas llojit të fibrave;
- ndarja e rrobave sipas ngjyrave;
- heqja e objekteve nga rrobat;
- klasifikimi në kategori të artikujve (restoranti, kuzhine, çarçafët, uniforma pune, rroba të klientëve, etj.);
- identifikimi dhe diferencimi i papastërtive.

3. Transportimi i të linjtave të seleksionuara pranë makinave larëse.

4. Vendosja e të linjtave në pajisjen larëse.

Për një përdorim optimal të makinave larëse, evitoni mbushjen e tyre në maksimum të kapacitetit duke bërë shpërndarje në mes të kazanit. Mos i ngjishni të linjtat në mënyrë që uji të kalojë mirë nëpër fibra. Në rast se keni më pak rroba për tu larë, si p.sh në larjen e rrobave të klientit, reduktoni kohën e larjes.



2.3 Përzgjedhja e detergjenteve larës, llogaritja e dozimit dhe vendosja e detergjenteve në vendet e përcaktuara sipas rregullit

1. Përzgjedhja e detergjenteve larës sipas llojit të linjtave dhe etiketave të tyre.

Në etiketa, trekëndëshi është simboli nëse duhet shtuar nëse agjenti është ose jo zbardhues.

Detergjenti pluhur, me agjentët zbardhues shumë efikas duhet të përdoren për ciklin 60 dhe 90 gradë për larjen e të të linjtave, me ngjyra të çelura ose të linjta shumë të pista (me paralarje nëse është e nevojshme).

Detergjenti likuid përdoret për temperaturat ndërmjet 30 dhe 60 gradë për larjen e tekstileve me ngjyrë dhe delikate, sepse nuk lë shenja të bardha. Ky detergjent nuk përmban agjentë zbardhues, pra nuk rrezikon zbardhjen e tyre. një detergjent likuid tretet më shpejt në ujë, i përshtatet më mirë fibrave sintetike dhe larjes me temperaturë të ulët pa paralarje.



KINI KUJDES

Mos përdorni detergjente për larje me dorë, sepse bëjnë shumë shkurmë, nuk do të kemi një shpëlarje të mirë, si rezultat do të dëmtohet edhe copa edhe pajisja larëse. Për të zvogëluar ndikimin e detergjenteve në natyrë duhen preferuar detergjentë ekologjikë sa më pak ndotës.



2. Llogaritja e masës së detergjenteve sipas peshës, llojit të rrobave dhe kapacitetit të makinerisë.

Është e rëndësishme të përdoret masa e duhur. Nëse tejkalohet masa e detergjentit ka mundësi që të shkatërrojë makinën larëse dhe rrobat të mos shpërlahen mirë. Për këtë arsye duhen lexuar udhëzimet në librin e pajisjeve larëse.

3. Vendosja e detergjentëve në vendet e përcaktuara sipas rregullit.



2.4 Përcaktimi i programeve të larjes sipas llojit dhe etiketës

Etiketat e fiksuara në brendësi të rrobave përmbajnë shumë simbole për sa i përket cilësisë, mirëmbajtjes dhe fortësisë. Cdo simbol na lejon të njohim llojin e larjes për cdo lloj cope. Atje tregohet shpërlarja dhe shtrydhja e duhur. Simboli i larjes me dorë është psh dora e futur në një legen. Temperatura e larjes gjithashtu nuk është e njëjta për cdo përbërje tekstile. Ajo tregohet me gradë celsius nga 30°-95°. Temperaturat më të ulëta janë për tekstilet delikate. Temperatura shoqërohet me një vizë (-) për tekstilet sintetike p.sh.

Programet në funksion të tekstileve:

Programi për copat pambuk: për çarcafët, këllëfët, peshqirat, të linjtat e restoranteve, uniformat pambuk etj. përfshirë edhe ngjyrat që nuk zbardhen. Ky program i përshtatet larjes energjike në temperatura 40° dhe 90°, me paralarje për ato shumë të pista dhe shtrydhje të shpejtë.

Programi për copat sintetike ose me ngjyra: për tekstilet më pak rezistente ndaj temperaturës, për pambuket që lëshojnë ngjyrë ose tekstilet që mblidhen. Për të përcaktuar temperaturën e duhur, lexoni etiketat.

Programi i përzier: për të linjta ku kombinohet pambuku me sintetiken. Ky program nuk lejon tkurrjen e rrobave të ndjeshme duke evituar cdo surprizë të pakëndshme.

Programi delikat: për të linjta e ndjeshme tek të cilat duam të ruajmë ngjyrat dhe përbërjen. Ky program korrespondon me larjen me dorë, në temperatura të ulta, 30-40 gradë, me një shtrydhje të ngadaltë ose pa shtrydhje.

Programi për copat prej leshi: për përbërje shumë delikate dhe leshi. Ky program kërkon larje të ftohtë, me lëvizje të ngadalta dhe pa shtrydhje. Ky program nuk lejon goditjen e fibrave duke evituar tkurrjen dhe penguar çngjyrosjen.



2.5 Punët pas larjes

Etapa e fundit e një cikli larjeje ka të bëjë me zbrazjen e makinës larëse në kontenierët përkatës për rroba të pastra. Transportimi i tyre për në makinën tharëse bëhet menjëherë.

Përzgjedhja e programit të tharjes bëhet sipas llojit të linjtave dhe të etiketës për rrobat e klientëve. Simboli katror tregon metodat e tharjes së rrobave. Përveç simboleve ka edhe tregues të tjerë për përdorimin e programit të tharjes në funksion të tekstilit që përdor. Pambuku mund të thahet lehtësisht në një makinë tharëse. Poliestra dhe lini thahen në një temperaturë të moderuar sipas etiketës.

Leshi, mëndafshi dhe tekstilet delikate. Mos e mbushni shumë makinën larëse. Rekomandohet tharje e drejtë për të eliminuar deformimin. Mund të bëhet në ajër dhe larg burimeve të nxehtësisë.



Mirëmbajtja e pajisjeve

- Mbani pajisjet hapur pas përfundimit të procesit.
- Pastroni vendin e deregjentëve me ujë të bollshëm dhe me presion.
- Pastroni pjesën lidhëse të derës me kazanin me një sfungjer ose furçë.
- Pastroni kazanin me uthull alkoli dhe kryeni larje bosh në 60 gradë celsius.
- Pastroni nga mbeturinat disa herë në vit tubon shkarkuese të ujit.
- Pastroni dhe zëvendësoni filtrin korrektësisht.



2.6 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në lavanderi

Kjo temë është trajtuar në RM 1.

REZULTATI MËSIMOR NR.3

NXËNËSI/JA KRYEN PROCESIN E HEKUROSIJES SË TË LINJTAVE NË LAVANDERI



3.1 Veshja e uniformës në vendin e punës

Kjo temë është trajtuar ne RM1.

3.2 Punët parapërgatitore për hekurosjen e të linjtave në lavanteri

Procesi i hekurosjes së të linjtave në lavanderinë e hotelit kalon në disa etapa.

Faza e parë: është verifikimi i funksionimit të pajisjeve hekurosëse. Në lavanderitë e hoteleve relativisht të vegjël, punonjësi i lavanderisë bën edhe kontrollin e funksionimit të pajisjeve, si hekurit për rrobat e klientit dhe pajisjeve të tjera si presat për hekurosjen e çarçafëve dhe pëshqirëve. Në lavanderitë e mëdha, këtë detyrë e kryen elektrikisti, sepse ka pajisje më shumë dhe më moderne dhe më të sofistikuara për një punonjës të thjeshtë lavanterie.

Faza e dytë: është transportimi i të linjtave pranë pajisjeve të hekurosjes dhe organizimi sipas llojit. Lloje të ndryshme tekstilësh, artikuj të ndryshëm kërkojnë teknika hekurosjeje të ndryshme. Për këtë arsye ato ndahen nëpër karroca ose shporta sipas llojit. Të linjtat hekurosen në makina të mëdha, ndërsa rrobat e klientëve në hekur dore, presë osë hekur kukull me avull.

Faza e tretë: është programimi i mënyrës së hekurosjes sipas llojit të hekurit.

Hekur i nxehtë: hekurosje në temperaturë maksimale 200 gradë celsius që i korrespondojnë programit të tekstileve prej pambuku ose lini duke përdorur edhe avullin.

Hekurosje e moderuar: hekurosje në një temperaturë maksikumi 150°C që korrespondon me programin e tekstileve delikate. Këshillohet përdorimi i një cope të lagur. Mund të përdorni avullin. Evitoni presionin.

Hekurosje e lehtë: hekurosja në temperaturë 110°C që korrespondon në programin e tekstileve shumë delikate si najloni. Këshillohet të hekurosen mbrapsht për të evituar shkëlqimin. Mos përdorni avullin.

3.3 Kryerja e procesit të hekurosjes

Procesi i hekurosjes kryhet në mënyrë të tillë që të lehtësojë punën e punonjësve të hotelit dhe të restorantit, kur ata shtrojnë krevatët ose tavolinat.



Foto 1: Hekurosja e mbulesave të tavolinave



Foto 2: Hekurosja e pecetave të restorantit



Foto 3: Hekurosja e çarçafëve





Hekurosja e rrobave të klientëve dhe personelit sipas treguesit të etiketës

3.4 Punët pas përfundimit të hekurosjes

Kjo temë është trajtuar në RM 1

- Paketimi dhe sistemimi i të linjtave dhe rrobave të klientit në vendet përkatëse.
- Transportimi i të linjtave në vendet e magazinimit.
- Mirëmbajtja e pajisjeve.
- Mbyllja e makinerisë në përfundim të procesit të hekurosjes.
- Pastrimi i pajisjeve të hekurosjes nga pluhurat.
- Kontrolli teknik.

3.5 Zbatimi i rregullave të higjienës, të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit në lavanteri

Kjo teme është trajtuar në RM 1.

